



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs



Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Në mbështetje të nenit 33 të Ligjit për Policinë dhe nenit 12 paragrafi 3 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë nxjerr:

RREGULLORE
Nr. 03/2019 PËR
OFRIMIN E SHËRBIMEVE DHE CAKTIMIN E TARIFAVE

Neni 1
Qëllimi

1. Me këtë rregullore përcaktohen llojet e shërbimeve, tarifat për shërbimet e ofruara dhe mënyra e pagesës, për shërbime të veçanta të ofruara nga Policia e Kosovës.
2. Mënyra e pagesës së shpenzimeve dhe lartësia e tyre për shërbimet e ofruara, caktohen në përputhje me dispozitat e nenit 8 dhe 9 të kësaj rregulloreje, si dhe vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, i cili do ti bashkangjitet kësaj rregulloreje.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Llojet dhe mënyra e ofrimit të shërbimeve të veçanta nga Policia, caktimi i lartësisë së tarifës dhe mënyra e pagesës për këto shërbime dhe procedurat administrative.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

Ministria – nënkupton Ministrinë për Punë të Brendshme e Qeverisë së Kosovës;

Policia – nënkupton Policinë e Republikës së Kosovës;

Taksë – është një kontribut i kërkuar për t'u paguar nga çdo person, i cili drejtpërdrejt përfiton për shërbimin e ofruar nga Policia;

Parashtresë – nënkupton kërkesa ligjore që i parashtrohet Policisë për ofrimin e shërbimeve të veçanta, siç përcaktohet me këtë rregullore.

Palë – personi fizik/ose përfaqësuesi i personit juridik që dorëzon parashtresën/kërkesën;

Përcjellje policore - angazhimin e së paku një veture motorike policore dhe dy zyrtarë policorë.

Materiet e rrezikshme - janë të gjitha ato materie të cilat janë të rregulluara me kategoritë nga 1 deri 9 ADR konventën ndërkombëtare, përkufizimi i së cilës është dhënë në Ligjin Nr.2004/6 , neni 1 dhe 2, i Ligjit nr. 04/l-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme.

2. Për policinë janë më të rëndësishme kategoritë 1 *Ekspllozivi* dhe 7 *Materiet Radioaktive* ku konventa e cekur ndërkombëtare dhe Ligjet e Republikës së Kosovës kërkojnë përcjellje policore apo ushtarake.

Neni 4

Procedurat për ofrimin e shërbimeve

1. Për ofrimin e shërbimeve të veçanta pala e interesuar është e obliguar të parashtojë kërkesë me shkrim në njësisë përkatëse pranë Policisë. Për ofrimin e disa shërbimeve, pala ka për obligim ta parashtojë kërkesën në afatin e përcaktuar me këtë rregullore.

2. Departamenti i shërbimeve mbështetëse me Procedurë Standarde të Operimit më hollësisht do ta rregullojnë mënyrën e parashtrimit të kërkesës, formularët e pagesave sipas kodeve përkatëse.

Neni 5

Kriteret për caktimin e tarifës

1. Tarifa për shërbime të ofruara nga ana e Policisë caktohen në bazë të:

- 1.1. Numrit të personelit policorë të angazhuar;
- 1.2. Profilit të njësisë policore që do të angazhohet;
- 1.3. Kohëzgjatjes së angazhimit;
- 1.4. Pajisjeve/mjeteve që do të përdoren;
- 1.5. Niveli / shkalla e rrezikshmërisë;
- 1.6. Lloji i shërbimit që ofrohet / kërkohet (administrativ, sigurim i objektit, përcjellje dhe asistencë); dhe
- 1.7. Koha –orari i ofrimit të shërbimit si në paragrafin 2 të nenit 6 të kësaj rregulloreje.

2. Mbështetur në llojin e shërbimit të ofruar ose asistencës, policia mund të merr për bazë edhe kriteret tjera, për caktimin e lartësisë së tarifës.

Neni 6

Mënyra e ofrimit të shërbimeve të veçanta

1. Policia e Kosovës ofron shërbime të veçanta përmes nënshkrimit të marrveshjeve kontraktuale për ofrim të shërbimeve të veçanta, mbështetur në memorandume bashkëpunimi si dhe nëpërmjet punës sekondare.
2. Shërbimet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni ofrohen gjatë orarit të rregullt të punës, jashtë orarit të rregullt të ditëve të punës, në ditë feste dhe në fundjavë (vikend).

Neni 7

Llojet e ofrimit të shërbimeve të veçanta

Pala ka të drejtë t'i parashtojë kërkesë Policisë (stacionit policorë, Drejtorisë rajonale, Departamentit përkatës) për ofrimin e shërbimeve të veçanta që kanë të bëjnë me realizimin e një të drejte personale ose të shërbimeve tjera të parapara me këtë rregullore, të cilat janë por nuk kufizohen vetëm në:

- Lëshimin e vërtetimit mbi humbjen e dokumenteve personale, tabelave të regjistrimit për mjete motorike etj;
- Vërtetim i të kaluarës kriminale;
- Kërkesa për lëshimin e lejes së armës; (pasi që MPB- vendos të diskutohet për shërbimet e PK për pranim dhe dorëzim të dokumenteve për leje).
- Sigurimi fizik i objekteve të institucioneve dhe agjencive shtetërore dhe publike në nivel qendror dhe lokal.
- Asistencë institucioneve bankave dhe institucioneve tjera, gjatë transportit të parasë dhe sendeve të tjera me vlerë të madhe monetare dhe artistike.
- Asistencë në ofrimin e sigurisë me rastin e tubimeve apo manifestimeve të ndryshme kulturore, sportive dhe ngjashëm me to;
- Asistim / ofrim i sigurisë Përmbauesit Privat;
- Asistenca në ofrimin e sigurisë në përcjelljen e mjeteve transportuese me material të rrezikshëm apo mjeteve motorike jashtë dimensionale;
- Asistenca në ofrimin e sigurisë ndërmarrjeve/kompanive publike dhe institucioneve tjera të pushtetit lokal dhe qendror, përfshirë institucionet dhe agjencionet e pavarura;
- Asistenca në ofrimin e sigurisë me rastin e aktivitetetve sportive
- Shqyrtimi i ankesave nga lëmi i trafikut rrugor;

Faqe 3 nga 6

Neni 8

Përcaktimi i lartësisë së taksave

1. Shuma e lartësisë së shpenzimeve/taksave administrative duhet paguar në kohën e dorëzimit të parashtrësës. Lartësia përcaktohet në bazë të vlerës së shërbimit, gjegjësisht llojit të parashtrësës, duke u bazuar në Tarifën për lartësinë e shpenzimit/taksës administrative të paraparë me këtë rregullore.
2. Nëse shërbimet e lartëcekura kërkohen / ofrohen në ditët e festave zyrtare dhe vikendit, tarifës së rregullt i shtohen edhe 50 % të shumës, ndërsa për ndërrim të natës tarifës së rregullt i shtohet edhe 30 % të shumës sipas ligjit të punës.

Neni 9

Administrimi dhe mënyra e pagesës së taksave

1. Taksat llogariten dhe paguhen në valutën Euro.
2. Taksat për shërbime paguhen në cilën do bankë komerciale të Kosovës-si dhe në institucionet tjera që ofrojnë këtë lloj shërbimi, në xhirollogarinë bankare të Policisë së Kosovës.
3. Pala, pas pagesës së taksës, është e obliguar t'ia prezantojë Departamentit/Drejtorisë fletëpagesën, si dëshmi për pagesën e saj.
4. Taksat e paguara në Polici, nga Sektori për financa, do të depozitohen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 10

Lirimi nga pagesa e shpenzimeve/taksave

1. Nga pagesa e taksës lirohen personat të cilët parashtrojnë kërkesën për vërtetim të kalua kriminale që ka të bëjë me marrëdhënien e punës, dhe;
2. Nga pagesa e taksës lirohen personat të cilët përfitojnë nga Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të ushtrisë çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre

Neni 11

Përcjellja nga Policia

1. Procedurat për kompensimin e taksës së policisë për dhënien e lejeve dhe angazhimin e përcjelljes policore është e rregulluar me Ligj dhe Udhëzim Administrative të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Infrastrukturës.
2. Për qëllim të kësaj rregulloreje, theksojmë që procedura e parashtrimit të kërkesës së

personit juridik i cili kërkon përcjellje të materieve të rrezikshme (eksplozivë, armë, municion, materie radioaktive e ngjashëm) bëhet në Departamentin për Rend Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, së paku 72 orë përpara për lejimin e përcjelljes policore të transportit apo importit të Materieve të Rrezikshme.

3. Departamenti për Rend Publik i Ministrisë së Punëve të Brendshme pasi që e lejon transportin apo importin e materies së rrezikshme së paku 48 orë më herët, e përcjell kërkesën e lejuar Policisë së Kosovës për përcjellje policore Drejtorisë për Planifikim dhe vlerësim operacional, e cila aprovon përcjelljen policore.

4. Përcjelljen policore të materieve të rrezikshme e organizon Drejtoria për Siguri dhe Mbikëqyrje të Komunikacionit Rrugor përmes Njësine së Specializuar për Përcjelljen e Materieve të Rrezikshme.

Neni 12

Mbingarkesa

1. Procedura e parashtrimit të kërkesës së personit juridik ose fizik i cili kërkon përcjellje të Mjeteve me mbi ngarkesë, së pari të drejtohet kërkesa Departamentit për Menaxhimin e Rrugëve të Ministrisë së Infrastrukturës.

2. Personi juridik pas miratimit-lejes nga ana e Departamentit për Menaxhimin e Rrugëve, parashtron kërkesë në Drejtorinë për Planifikim dhe vlerësim operacional.

3. Përcjelljen policore të mjeteve me mbi ngarkesë e organizon dhe zbaton Njësia Policore e Komunikacionit rrugor e caktuar nga Drejtoria për Planifikim dhe vlerësim operacional.

Neni 13

Pagesa e Kompensimit për përcjellje dhe shërbimet tjera

Kompensimi për përcjellje zyrtare për Institucione, Organizata, Asociacione, Mjete me mbi ngarkesë, Transport të Materieve të Rrezikshme, Eksploziv, Armë, Municion dhe personave tjerë juridik dhe fizik është:

- | | |
|--|---------------------|
| 1.1 Për secilin angazhim të zyrtarit policor të rendit publik, ----- | 5,00 euro / 1 orë. |
| 1.2 Për secilin angazhim të zyrtarit policor Njësive Speciale----- | 10,00 euro / 1 orë. |
| 1.3 Për shfrytëzimin e motoçikletës zyrtare ----- | 2,00 euro / 1 km. |
| 1.4 Për shfrytëzimin e veturës zyrtare të udhëtarëve ----- | 2,20 euro / 1 km. |
| 1.5 Për shfrytëzimin e veturës zyrtare fushore -xhip----- | 3,50 euro / 1 km. |
| 1.6 Për shfrytëzimin e kombi busit zyrtar ----- | 3,00 euro / 1 km. |
| 1.7 Për shfrytëzimin kamionit zyrtar pa rimorkio ----- | 3,50 euro / 1 km. |
| 1.8 Për shfrytëzimin kamionit zyrtar me rimorkio ----- | 4,00 euro / 1 km. |
| 1.9 Për shfrytëzimin autobusit zyrtar ----- | 4,00 euro / 1 km. |
| 1.10 Për shfrytëzimin e barkës me motor të jashtëm deri 50KF----- | 15, 00 euro / 1 orë |


Neni 14
Afati i pagesës për shërbimet e ofruara

1. Afati i pagesës për shërbimet e ofruara të përcjelljes policore është 8 ditë nga dita e pranimi të obligimit financiar Personit juridik, të cilit iu është ofruar shërbimi nga ana e Policisë së Kosovës.
2. Në rast të mos përmbajtjes së afatit të paraparë prej 8 ditëve, nga ana e Personit juridik të cilit i është ofruar shërbimi, do ti llogaritet kamata ndëshkuese, sipas përqindjes së kamatës të caktuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për çdo ditë vonese në përmbushjen e obligimit financiar.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Z. Rashit Qalaj



28/03/2019





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs
Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate



Bazuar në Ligjin për Policinë, nenin 33, paragrafi 2 nën paragrafi 6, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë nxjerr:

VENDIM PËR TARIFA



I. Me këtë vendim përcaktohen tarifat që duhet të paguar për ofrimin e shërbimeve nga Policia e Kosovës.

II. Tarifat e cekura në pikën 1 të këtij vendimi janë si në vijim:

Nr.	Shërbimi	Tarifa	
		Çmimi	Njësia
1	Lëshimin e vërtetimit mbi humbjen e dokumenteve personale, tabelave të regjistrimit të mjeteve motorike etj.	1 €	
2	Lëshimi i vërtetimit për të kaluarën kriminale.	1 €	
3	Vërtetim i të kaluarës për kundërvajtjet në trafik – aksidentet, tiketat, pikët negative, masat mbrojtëse	1€	
4	Statistika të ndryshme lidhur me aksidentet në trafikun rrugor (analiza, hulumtime shkencore, avancime shkencore e të ngjashme).	2€	
5	Raportet e aksidenteve të trafikut, tiketat, veçanërisht kur kërkohen fotografitë e aksidenteve, raportet për herë të dytë, kopjet e dokumentacioneve të ndryshme ... etj.	5€	
6	Ri konstruimi i vendit të ngjarjes për aksident trafiku	50€	
7	Kërkesë për lëshimin e lejes së armës.	5 €	
8	Asistim/ofrim i sigurisë përmbauesve privat.		Sipas Nenit 13
9	Shqyrtim i ankesave nga lëmi i trafikut rrugor	5 €	
10	Asistenca në ofrimin e sigurisë në përcjelljen e mjeteve transportuese me materiale të rrezikshme apo mjeteve motorike jashtë dimensioneve.		Sipas Nenit 13
11	Sigurimi fizik i objekteve të institucioneve dhe agjencive shtetërore dhe publike.	3 €	1 Orë
12	Asistencë institucioneve të nivelit lokal & qendror dhe ndërmarrjeve/kompanive publike gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.	4 €	1 Orë
13	Asistencë në ofrimin e sigurisë gjatë aktiviteteve sportive dhe kulturore.	5 €	1 Orë
14	Asistime të ndryshme në bllokim të rrugëve në kohë të caktuar gjatë minime të ndryshme.		Sipas Nenit 13
15	Asistencë institucioneve bankave dhe institucioneve tjera, gjatë transportit të paras dhe sendeve tjera me vlerë të madhe monetare ose artistike.	1300 €	Një përcjellje

16	Përcjellje të personaliteteve (vendore & ndërkombëtare) gjatë aktiviteteve private, jashtë detyre zyrtare.		Sipas Net 13
17	Kompensim për angazhimin e zyrtareve policore, pajisje policore (pranga, shufra, uniforma etj) pajisje speciale (pengesa, barrierat policore, mbrojtëset personale, mbrojtëset policore etj <u>pajisje të cilat mund të shfrytëzohen për incizimin e filmave, në teatër, etj</u>)		Sipas Net 13
18	Kompensimi për mjete të lundrimit, pajisje dhe aparate të ndryshme		Sipas Net 13
19	Huazimi i poligoneve për gjuajtje	50€	
20	Organizimi i trajnimeve të ndryshme, vozitje emergjente etj		Sipas Net 13
21	Kompensim për qentë zyrtare		Sipas Net 13
22	Kompensim për objektet sportive policore (atje ku është e mundur)	30 €	

Kompensimi për përcjellje			
Nr.	Shërbimi	Tarifa	
		Çmimi	Njësia
	Për secilin angazhim të zyrtarit policor	5	
	Për secilin angazhim të zyrtarit policor nga njësitë e specializuara	10	
	Për shfrytëzimin e motoçikletës zyrtare	2	
	Për shfrytëzimin e veturës zyrtare të udhëtarëve	2.2	
	Për shfrytëzimin e veturës zyrtare fushore -xhip	3.5	
	Për shfrytëzimin e kombi busit zyrtar	3	
	Për shfrytëzimin kamionit zyrtar pa rimorkio	3.5	
	Për shfrytëzimin kamionit zyrtar me rimorkio	4	
	Për shfrytëzimin autobusit zyrtar	4	
	Për shfrytëzimin e barkës me motor të jashtëm deri 50KF	15	

III. Policia e Kosovës ruan të drejtën e ndryshimit dhe plotësimit e këtyre tarifave,

IV. Ky vendim hynë në fuqi pas nënshkrimit të Drejtorit të Përgjithshëm dhe fillon të zbatohet nga data 03.01.2020

Z.Rashit Qalaj

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës



Prishtinë:

31.12.2019